



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PLANI I PUNËS I KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2017

Shkurt, 2017

www.kqz-ks.org



Plani i Punës i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2017

Publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Shkurt 2017.

Për më shumë informacion kontaktoni Sekretariatit e KQZ-së,
Adresa: Rr. Migjeni, nr.21 Prishtinë, 10000.
Telefoni: +381(0)38 211034. E-mail: infokqz@kqz-ks.org

© Komisioni Qendror i Zgjedhjeve 2017

Versione elektronik i këtij dokumenti është në dispozicion në linkun: <http://www.kqz-ks.org/sq/publikime>

SHKURTESAT

ACEEEO	Asociacioni i Zyrtarëve Zgjedhor Evropian
GPLV	Grupi Punues për Përmirësimin e Listës së Votuesve
IFES	Fondacioni ndërkombëtar për sisteme zgjedhore
IP	Informimi Publik
KKZ	Komisionet Komunale të Zgjedhjeve
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KVV	Këshillat e vendvotimeve
OJQ	Organizatat Jo Qeveritare
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
QNR	Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve
QV	Qendra e Votimit
SKQZ	Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
VV	Vendvotim
SHV	Shërbimi Votues
LV	Lista e Votuese
ZFK	Zarfi i Fletëvotimit me Kusht
FPR	Formulari i Përputhjes së Rezultateve
FRK	Formulari i Rezultateve të Kandidatëve
DAP	Departamenti i Administratës dhe Përkrahjes
DOZ	Departamenti i Operacioneve Zgjedhore
DÇL	Departamenti për Çështje Ligjore
DTI	Departamenti i Teknologjisë Informativë
KT	Koordinimi në teren
KOZ	Këshilli për Operacione Zgjedhore
KP	Këshilli për Personel
KBF	Këshilli për Buxhet dhe Financa
KA	Komiteti i Auditimit
KÇL	Këshilli për Çështje Ligjore
KMJ	Këshilli për marrëdhënie me jashtë
ZRPP	Zyra për Regjistrim të Partive Politike

HYRJE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është institucion i pavarur i themeluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sipas nenit 139, paragrafi 1 “është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve e referendumet dhe shpall rezultatet e tyre”. Në përmbushjen e këtyre detyrave dhe obligimeve kushtetuese, KQZ-ja mbështetet nga dy trupa administrative siç janë, Sekretariati i KQZ-së dhe Zyra për Regjistrimin dhe Certifikimin e Partive Politike.

Me qëllim të implementimit të përgjegjësive dhe detyrave të veta harton dhe miraton këtë Plan të Punës për vitin 2017 i cili paraqet prioritetet e institucionit për vitin 2017 dhe jep përmbledhje të aktiviteteve të planifikuara për realizimin e synimeve operative të përcaktuara. Po ashtu, i njëjti përcakton edhe afatet kohore, përgjegjësit për kryerjen e secilit prej aktiviteteve dhe objektivave të parapara, si dhe koston financiare.

PËRGJEGJËSITË DHE FUNKSIONET

Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, janë përcaktuar në mënyrë të përgjithshme përgjegjësitë dhe funksionet e KQZ-së, ndërsa me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, janë përcaktuar në mënyrë më të specifikuar këto përgjegjësi dhe funksione të KQZ-së duke përfshirë edhe ato të Sekretariatit të KQZ-së dhe Zyrës për Regjistrimin dhe Certifikimin e Partive Politike.

Neni 64 i këtij Ligji përcakton qartë përgjegjësitë dhe funksionet e KQZ-së, si:

- a) përgatitja dhe shpallja e rregullave, formave dhe procedurave zgjedhore që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji dhe me çdo çështje tjetër që ka të bëjë me drejtimin e zgjedhjeve në kuadër të kompetencës së saj;
- b) publikimi i të gjitha rregullave, udhëzimeve dhe procedurave zgjedhore duke i bërë ato të arritshme për opinionin;
- c) krijimi dhe mbajtja e listës së personave që kanë të dejtë të votojnë në zgjedhje të veçanta;
- d) mbajtja e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikimin e Partive Politike në mënyrën e paraparë me këtë ligj;
- e) përpilimi dhe miratimi i fletëvotimeve dhe materialet tjera zgjedhore;
- f) akreditimi i vëzhguesve zyrtarë të zgjedhjeve;
- g) certifikimi i listës së votuese lidhur me zgjedhjet;
- h) certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve;
- i) publikon rezultatet e zgjedhjeve;
- j) themelon komisionet komunale të zgjedhjeve dhe këshillat e vendvotimeve;
- k) cakton ekipet e numërimit për çdo këshill të vendvotimit për aq sa garantojnë rrethanat.

KËSHILLAT E KQZ-SË

Në bazë të Rregullores së Punës, Komisioni ka 5 këshilla të përhershëm:

- a) Këshilli për marrëdhënie me jashtë
- b) Këshilli për Personel
- c) Këshilli për Buxhet dhe Financa
- d) Këshilli për Çështje ligjore
- e) Këshilli për Operacione zgjedhore.

KQZ ka themeluar edhe Komitetin e Auditimit.

Gjithashtu KQZ ka themeluar edhe Grupin Punues për Përmirësimin e Listës së Votuesve.

Roli i këshillave është shqyrtimi i çështjeve të caktuara dhe përgatitja e rekomandimeve apo raporteve për miratim nga KQZ-ja.

PLANI VJETOR I PUNËS

Plani Vjetor i Punës përcakton në mënyrë të detajuar të gjitha veprimet të cilat duhet të ndërmerren për t'i arritur synimet dhe objektivat strategjike. Bazuar ne ciklin e zgjedhjeve ne Kosove, këtë vit do te mbahen Zgjedhjet Lokale 2017 andaj Plani reflekton aktivitetet qe Sekretariati dhe Komisioni duhet te ndërmarrin ne funksion te organizimit dhe administrimit te zgjedhjeve lokale.

Ky Plani i Punës, gjithashtu, identifikon aktivitetet konkrete, bartësit, orarin kohor, treguesit e performancës, dhe vlerësimet buxhetore për zbatimin e secilit aktivitet. Identifikimi i këtyre aktiviteteve është bërë në bashkëpunim të ngushtë në mes anëtarëve të Komisionit dhe Sekretariatit.

Me miratimin e Planit vjetor të Punës për vitin 2017, KQZ merr përsipër angazhimet dhe përgjegjësitë në lidhje me zbatimin e këtij plani. Menaxhmenti dhe stafi i Sekretariatit, përmes kontributit të tyre në identifikimin e veprimeve dhe aktiviteteve konkrete gjatë hartimit të Planit të Punës, njëkohësisht zotohen se do të përfshihen dhe do ta zbatojnë këtë plan.

Plani i Punës është bazuar në synimet dhe objektivat e përgjithshme dhe synimet e përcaktuara ne Planin Strategjik të KQZ-së 2015-2018 dhe obligimet tjera ligjore

Plani i Punës është i ndare ne tetë fusha kryesore që ndërlidhen me shtyllat strategjike të Planit Strategjik të KQZ-së 2015-2018 dhe aktivitetet tjera te mbështetura nga OSCE.

Meqë Plan i Punës është një dokument që duhet t'i përshtatet rrethanave, nevojave dhe mundësive buxhetore të KQZ-së, në çdo tre (3) muaj duhet të raportohet për progresin e implementimit të tij, si dhe të shqyrtohet ne mesin e vitit, përkatësisht në muajin qershor .

SHTYLLA STRATEGJIKE 1: Operacionet Zgjedhore

Synimet: Aktivitete zgjedhore të planifikuara me saktësi, Procedura të thjeshtësuara zgjedhore , Votim më i qasshëm për votuesit, Rezultate të zgjedhjeve të sakta dhe të shpejta

Nr	AKTIVITETET	PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE	NJËSIA PËRGJEGJËS PËR ZBATIM	PËRGJEGJËS PËR MONITORIM	AFATI KOHOR												TREGUESIT E PERFORMANCËS	Vlerësimi i koston	
					I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII		Kosto	Burimi
1	Hartimi i Plani Operacional për Zgjedhjet Lokale 2017	KQZ harton planin operacional i cili përmban të gjitha aktivitetet ligjore dhe operacionale. Plani Operacional fillon të zbatohet në të njëjtën ditë kur shpallen zgjedhjet. Plani do të përpilohet duke përfshirë dy data – që ju referohen organizmit të procesit zgjedhor në periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve dhe në periudhën 5 muaj para datës së zgjedhjeve.	SKQZ	KOZ/KOZ													Plani Operacional me të gjitha aktivitetet zgjedhore i hartuar dhe harmonizuar	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
2	Hartimi i Planit të Punës për vitin 2018	KQZ organizon punëtori për vlerësimin e implementimit të planit të punës të vitit 2017 dhe hartimin e planit të punës 2018	SKQZ	KOZ/KOZ													Plani i Punës 2018 i hartuar	13,500.00 Euro	Buxheti i KQZ-së
3	Raport lidhur me implementimin e Planit të Punës 2017	Pas çdo tre-mujor, sekretariati përgatitë raport lidhur me implementimin e Planit të Punës për periudhën përkatëse.	SKQZ	KOZ													Raportimi jo me vonë se data 10 pas çdo tre mujori	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
4	Rishikimi i ndërmjetëm i Strategjisë së KQZ-së 2015-2018	Me përkrahje nga IFES që të bëhet vlerësimi i ndërmjetëm i progresit në implementim të Planit Strategjik 2015-2017. Ky aktivitet do ndihmojë KQZ-në për të shqyrtuar përparimin kundruall të gjitha objektivave strategjike duke i mundësuar KQZ-së për të bërë ndonjë ndryshim të planit për të adresuar ndryshimet në mjedisin ku vepron ose disponueshmërinë e resurseve. Raporti që do prodhohet po ashtu do të jetë i dobishme në zhvillimin e planit të ardhshëm strategjik të KQZ-së. Aktiviteti do të përfshijë konsulta dhe organizim të punëtorive.	SKQZ/IFES	KOZ/KOZ													Strategjia e KQZ-së 2015-2018 e rishikuar	n/a	Financuar nga IFES
5	Miratimi i planit final të prokurimit për vitin 2017	Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, çdo autoritet kontraktues do të përgatisë, duhet t'i dorëzojë AQP-së, një planifikim përfundimtar me shkrim që i identifikon me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon ti prokurojë gjatë vitit të tillë fiskal.	Prokurimi	KBF/KOZ													Plani final i prokurimit i miratuar	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
6	Hartimi i planit preliminar të prokurimit për vitin 2018	Jo më pak se tridhjetë (30) ditë para fillimit të çdo viti fiskal, secili autoritet kontraktues duhet të përgatisë planifikimin paraprak të prokurimit, të dorëzojë me shkrim të Zyrtari Kryesor Administrativ i Autoritetit Kontraktues, në të cilat identifikohen me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që autoriteti kontraktues parasheh t'i prokurojë gjatë vitit fiskal në fjalë.	Prokurimi	KBF/KOZ													Plani preliminar i prokurimit i hartuar	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
7	Hartimi i planit të buxhetit për vitin 2018 - 2020	Pas aprovimit të KASH 2018-2020 nga Kuvendi i Kosovës, fillon procesi i hartimit të Planit të Buxhetit 2017-2019 të KQZ-se. Hartimi i Planit të Buxhetit bazohet në kërkesat buxhetore të cilat janë të bazuara në plane dhe projekte të njëjësive kërkuese. Dokumenti i parë i planit të buxhetit bazohet në Qarkoren buxhetore 2017/ 01 dhe dorëzohet në MF në muajin qershor. Më Qarkoret buxhetore 2017/ 02- korrik; 2017/03 gusht- shtator të MF caktohen kufijtë final dhe kufijtë e forte buxhetor në baze të cilëve duhet të rishikohet buxheti i planifikuar i KQZ-se dhe të përshtatet me qarkore buxhetore.	DAP	KBF/KOZ													Plani i buxhetit i hartuar dhe miratuar	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
8	Implementimi i Planit të Prokurimit për vitin 2017	KQZ implementon Planin e Prokurimit për vitin 2017, duke zhvilluar aktivitetet e parapara me plan për prokurimin e shërbimeve apo furnizimeve.	Prokurimi	KBF/KOZ													Zbatimi i aktivitetëve të planifikuar në Plan	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
9	Korniza afatmesme e shpenzimeve 2018 - 2020	Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2018 - 2020 është dokument që i paraprinë procesit buxhetor dhe shërben për realizimin e strategjisë dhe qëllimeve të KQZ-se përmes objektivave që realizohen përmes aktivitetëve dhe projekteve në një vit të rregullt buxhetor. Ky dokument në MF dorëzohet në fillim të muajit prill.	DAP	KBF/KOZ													Dokumenti i KASH-it i hartuar dhe miratuar	pa kosto	Buxheti i KQZ-së

10	Marrëveshje bashkëpunimi në mes KQZ-së dhe Ministrisë së Diasporës	Bashkëpunimi në mes KQZ-së dhe MD, me qëllim të përfshirjes së pikave shpërndarëse në proceset zgjedhore, me qëllim të informimit të votuesve jashtë vendit, Identifikimi i shoqatave, asociacioneve të ndryshme, si pika shpërndarëse, Përfshirja e Ministrisë së Diasporës në procese zgjedhore, me qëllim të informimit të votuesve jashtë Kosovës, Krijimi i një data baze të saktë për të dhënat e shoqatave dhe asociacioneve të ndryshme të mërgatës.	DOZ	KOZ/KOZ									Marrëveshja e nënshkruar	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
11	Zbatimi i Pilot Projektit -skanimin e Formularëve të Rezultateve	· Hartimi i procedurave në bazë të të cilave do të funksionojë sistemi i skanimit të Formularëve të Rezultateve. · Përgatitja e specifikave teknike në bazë të procedurave të skanimit të Formularëve rezultateve · Testimi i Procedurave të skanimit të Formularëve të Rezultateve me qëllim të identifikimit të nevojave për përmirësim aty ku është e aplikueshme	QNR/DTI	KOZ/KOZ									Pilot projekti i zbatuar	65,000.00 Euro	Buxheti i KQZ-së
12	Zbatimi i Pilot Projektit -evidentimin dhe gjurmimin e materialit zgjedhor	·Hartimi i procedurave në bazë të të cilave do të funksionojë sistemi i regjistrimit/ evidentimit dhe gjurmimit e materialit zgjedhor ·Përgatitja e specifikave teknike në bazë të procedurave të regjistrimit të materialit të ndjeshëm. ·Testimi i dhe trajnimi i stafit për sistemin e regjistrimit të materialit të ndjeshëm.	QNR /DTI/ DAP	KOZ/KOZ									Pilot projekti i zbatuar	30,000.00 Euro	Buxheti i KQZ-së
13	Organizimi i Projektit “Simulimi i Procesit Zgjedhor”	SKQZ do të beje testimit të aftësive, vigjilencës dhe saktësinë e stafit të SKQZ-se se sa janë të përgatitur ne menaxhimin e situatave ne ditën e zgjedhjeve.	KT/SKQZ	KOZ/KOZ									Lista e pjesëmarrësve dhe raporti i zbatimit	10,000.00	Buxheti i KQZ-së
14	Zhvillimi i Strategjisë për modernizimin e QNR-së	Ky aktivitet synon të fillojë zhvillimin e një strategjie për modernizimin dhe rritjen e efikasitetit të operacioneve të QNR. Kjo do të përfshijë shqyrtimin e mundësive të përshtatshme që mund të jenë në dispozicion dhe me kosto efektive si dhe teknologjinë që mund të përdoret për mbështetje operacioneve të QNR-së. Kjo strategji do konsideroj edhe implikimet ligjore dhe procedurale të përdorimit të çfarëdo teknologjie të tillë. Edhe pse nuk pren ndryshime të mëdha në sistemet aktuale që përdoren në QNR por rekomandimet e nxerrura nga ky rishikim do synohen të zbatohen para fillimit të zgjedhjeve të planifikuara komunale të vitit 2017.	QNR/IFES	KOZ/KOZ									Strategjia e hartuar	n/a	Financuar nga IFES
15	Rishikimi i procedurave të QNR-së	Rishikimi i Procedurave të QNR-së me qëllim të identifikimit të nevojave për përmirësim aty ku është e aplikueshme	QNR	KÇL/KOZ/KOZ									Procedurat e rishikuara	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
16	Thjeshtëzimi, testimi dhe ridizajnimi i formularëve zgjedhor	Formularët zgjedhor të thjeshtëzuar në mënyrë që të plotësohen më lehte nga stafi zgjedhor. Formular zgjedhor të dizajnuar që të jenë më lehte të kuptueshëm nga votuesit.	QNR/DOZ/DTI/D AP	KOZ/KOZ									Formularët e thjeshtuar dhe ridizajnuar	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
SHTYLLA STRATEGJIKE 2: Edukimi dhe informimi i votuesve															
Synimet: Votues të informuar për të drejtat zgjedhore dhe të motivuar për rëndësinë e realizimit të tyre, Komunikimi i përhershëm me publikun në formë të qasshme															
17	Shqyrtimi, miratimi dhe implementimi i Strategjisë së informimit publik	Hartimi i Strategjisë ka për qëllim informimin dhe edukimin e votuesve dhe palëve tjera relevante me informacion zgjedhor lidhur me zgjedhjet, për rritjen e pjesëmarrjes ne votim dhe, për rrrjedhojë, minimizimin e të gjitha elementeve, të cilat mund të cenojnë integritetin e procesit zgjedhor ,uljen e numrit të fletëvotimeve te pavlefshme, si dhe ndërgjegjësimin e qytetareve për rolin e tyre ne mbajtjen e një procesi te rregullt zgjedhor.	DOZ	KOZ/KOZ									Strategjisë së informimit publik e miratuar dhe zbatuar	450.000.00 Euro	Buxheti i KQZ-së

18	Ridizajnimi i ueb faqes se KQZ-së	Duke pasur parasysh që KQZ-ja përgjatë tri viteve, prej kur është lansuar ueb faqja aktuale ka avancuar me shërbimet që ofron për votuesit, është shfaqur nevoja që të njëjtat të vihen në dispozicion për publikun. Prandaj, ridizajnimi i ueb faqes do të akomodonte platformat e reja të cilat KQZ-ja ka zhvilluar dhe do të përmirësonte eksperiencën e përdoruesit gjatë shfletimit të saj. Gjithashtu, ridizajnimi i ueb faqes shfaqet si nevojë karshi ndryshimeve teknologjike, të cilat janë mjaft dinamike në këtë fushë. Teknologjia që përdoret për zhvillimin e ueb faqeve ka ndryshuar shumë shpejtë gjatë kësaj kohe, prandaj edhe KQZ-ja do të jetë në hap me këto ndryshime. Prej kohës kur është zhvilluar ueb faqja e KQZ-së, mënyra se si përdoruesit bashkëveprojnë me ueb faqen ka pësuar ndryshime të shumta. Prandaj, këtë mënyrë të re të punës do ta kenë edhe përdoruesit që vizitojnë ueb faqen zyrtare të KQZ-së.	DTI/DOZ /ZËDHËNËSI / IFES	KOZ/KOZ														Ueb faqja e KQZ-së e ridizjuanuar	7,000.00 Euro	Buxheti i KQZ-së
----	-----------------------------------	--	---------------------------	---------	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	-----------------------------------	---------------	------------------

SHTYLLA STRATEGJIKE 3: Fuqizimi Institucional

Synimet: Ruajtja e stafit plotësisht të trajnuar, profesional dhe gjithëpërfshirës , Trupa zgjedhore (KKZ dhe KVV) kompetente dhe efektive, Strukturë organizative në pajtim me qëllimet e KQZ-së, Qëndrueshmëri financiare

19	Zhvillimi i programeve për e-mësimin (e-learning) për Platformën për Modernizim të Zgjedhjeve	Zhvillimi i programeve interaktive të trajnimit, të cilat do të jenë të qasshme online dhe inkorporohen në modulën për trajnime online.	DOZ/DTI	KOZ/KOZ														Modulet interaktive të zhvilluara	n/a	Financuar nga IFES
20	Analizimi dhe plotësim/ndryshimi i doracakut të trajnimit	Doracak i cili përmbush standardet zgjedhore	DOZ	KOZ/KOZ														Doracak i rishikuar dhe i miratuar	n/a	Financuar nga IFES
21	Hartimi i Procedurës për Votim jashtë Kosovës	Përfshirja e të gjitha hapave të Periudhës së Regjistrimit dhe Periudhës së Votimit jashtë Kosovës (Përshkrim i procesit për regjistrimin e votuesve, Periudhën e votimit dhe vlerësimin të pakove me fletëvotime. Rishikimi dhe azhurnimi/freskimi i të gjitha procedurave (regjistrimi, votimi, pranim-dorëzim dhe vlerësimi i pakove të fletëvotimeve etj.) gjithmonë të aplikueshme dhe konform rregullave Ligjore.	DOZ	KOZ/KCL/KOZ														Procedura për votim jashtë Kosove e hartuar	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
22	Vëzhgimi i zgjedhjeve, pjesëmarrja në trajnime, vizita studimore lidhur me proceset zgjedhore	Me qëllim të marrjes së përvojave dhe praktikave të mira, KQZ bën vëzhgimin e proceseve zgjedhore në shtetet e rajonit.	SKQZ/KOZ	KMJ/KOZ														Vëzhgimi i zgjedhjeve sipas kalendarit zgjedhor dhe hartimi i raportit të vëzhgimit	40.000.00	Buxheti i KQZ-së
23	Punëtori për hartimin dhe ndryshimin rregullat ivës	Mbajtja e punëtorisë për hartimin dhe ndryshimin e rregullat ivës	SKQZ	KÇL/KOZ														Dokumentet e hartuara dhe rishikuara	15,000.00	Buxheti i KQZ-së
24	Politikat gjinore dhe Plani i vjetor i veprimit	Qëllim i këtij aktiviteti është zhvillimi i politikave gjinore dhe planit vjetor të veprimit gjinor për KQZ-në. Politikat gjinore dhe plani i veprimi do të adresojnë çështje të ndërlidhura me personelit e KQZ-së, buxhetimin gjinor, mundësitë e trajnimit të stafit dhe aktiviteteve në terren. IFES pastaj do të punojë me KQZ-në për të siguruar që Plani Strategjik, Plani i Punës për 2017 si dhe plani i M&E të rishikohen dhe të adaptojnë masat e parapara në planin e hartuar të veprimit gjinor.	SKQZ/IFES	KP/KOZ/KOZ														Dokumenti i politikave dhe plani i veprimit	n/a	Financuar nga IFES
25	Trajnim i dedikuar për hartimin e Projekt-Propozimeve dhe buxhetim adekuat	Ky aktivitet ka synim qasjen më efektive në financim të projekteve të KQZ-së. IFES do trajnoj stafi nga KQZ që merret me hartim të projekteve në teknikat e hartimit dhe modelet më të mira të projekt propozimeve për donatorë. Po ashtu, do trajnohet stafi për hartimin e arsytimit më të mira për kërkesat për financim nga buxheti i Kosovës. IFES me pas do të ofroj këshilla dhe gjatë procesit të hartimit të projekteve kurdo që është e nevojshme.	SKQZ/IFES	KOZ/KOZ														Trajnimi i mbajtur dhe stafi i KQZ-së i trajnuar për hartimin e Projekt-Propozimeve dhe buxhetimit	n/a	Financuar nga IFES
26	Plani i trajnimeve 2017-2018	Të bëhet vlerësimi i zbatimit të Planit të vitit 2016 si dhe të bëhet vlerësimi i nevojave për trajnim për vitin 2017. Nevojat dhe kërkesat e identifikuar për trajnim do të përfshihen në Planin e Trajnimit të KQZ-së për vitin 2017 (dhe 2018). IFES do mbështes të paktën një pjesë të trajnimeve nga Plani i Trajnimeve.	SKQZ/IFES	KOZ/KOZ														Plani i trajnimit i hartuar	n/a	Financuar nga IFES
27	Zbatimi i Planit të Trajnimit 2016-2017	Staf profesional të SKQZ-së	DOZ/DAP	KOZ/KP/KOZ														Trajnimet e mbajtura sipas Planit të trajnimit		Buxheti i KQZ-së/Financuar nga IFES

SHTYLLA STRATEGJIKE 4: Lista e votuesve

Synimet: Një listë të votuesve të saktë dhe të plotë

28	Përmirësimi dhe qëndrueshmëria e Listës së Votuesve "Vendbanimi im, Vendvotimi im"	Plotësimi i MASTER Listës, si mekanizëm i caktimit të votuesve edhe me emërtime të rrugëve në bazë të sistemit unik të adresave, Themelimi i qendrave të reja të votimit në zonat urbane, Shikimi i mundësisë së krijimit të një aplikacioni për caktimin e votuesve në qendra të votimit në bazë të adresave dhe emrave të rrugëve, Mundësia për blerjen e hartave nga fotografimi i planifikuar i vitit 2017, që do të bëhet nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Mundësia e caktimit të votuesve në qendra të votimit për dy komuna për Zgjedhjet Lokale 2017.	DOZ	KOZ/KOZ														40.000.00	Buxheti i KOZ-së	
29	Mbajtja e takimeve të Grupeve Punuese për përmirësimin e Listës së Votuesve	Inkorporimi i sistemit të adresave në Regjistrin Qendror Civil, Përmirësimi, saktësia dhe gjithë përfshirja në Listën e Votuesve	DOZ	GPLV														Takimet e mbajtura	pa kosto	Buxheti i KOZ-së

SHTYLLA STRATEGJIKE 5: Pjesëmarrje në zgjedhje

Synimet: Pjesëmarrje më e madhe në zgjedhje, Qasje e barabartë dhe gjithëpërfshirëse në zgjedhje

30	Zhvillimi i Aplikacionit Online për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës	Krijimi i aplikacionet online për regjistrim të votuesve jashtë vendit, Krijohen kushte më të lehta për regjistrim, Rritja e pjesëmarrjes në zgjedhje e qytetarëve që jetojnë jashtë vendit	DOZ/DTI	KOZ/KOZ														Aplikacioni i zhvilluar	60,000.00 Euro	Buxheti i KOZ-së
31	Publikimi i trendëve zgjedhore	Publikimi i dokumentet me të dhënat statistikore për daljen e votuesve në zgjedhje, të ndara në grupmosha, gjini, komuna	QNR/DTI	KOZ/KOZ														Dokumenti i aprovuar dhe publikuar	pa kosto	Buxheti i KOZ-së
32	Hartimi i Planit të rreziqeve	KOZ do hartoj planin e menaxhimit të rrezikut që do të përfshijnë planet për veprimet e nevojshme për të zbutur rreziqet e identifikuar gjatë vlerësimit, të tilla si dështim apo proceseve të meta të prokurimit, gabimet dhe lëshimet në regjistrimin e votuesve, si dhe çështjet që lidhen me sigurinë zgjedhore apo pranimin e rezultateve të zgjedhjeve. Në zhvillimin e një metodologjie të menaxhimit të rrezikut dhe planin për KOZ. IFES do të angazhojë një ekspert të hartimit të planeve për menaxhimin e riskut për të trajnuar KOZ në lidhje me metodologjinë e vlerësimit të rrezikut. Pas trajnimit, IFES do të mbështesë KOZ-së për të kryer vlerësimin e rrezikut të aktiviteteve të tyre, dhe për të zhvilluar shabllonit për menaxhimin e rrezikut që i plotëson edhe kriteret e institucioneve të Kosovës (për auditim) por edhe dhe nevojat zgjedhore operacionale.	SKOZ/IFES	KOZ/KOZ														Plani i rreziqeve i hartuar	n/a	Financuar nga IFES
33	Vlerësimi i qasshmërisë së të dhënave (Open Data)	ME ndihmën nga IFES, KOZ-së për të kryer një vlerësim për të dhënat e hapura (Open Data) Vlerësimi do të shqyrtojë praktikën ekzistuese e të dhënave të KOZ-së, për të identifikuar mjetet me të cilat të dhënat e KOZ-së vihen në dispozicion të publikut si dhe se si mund të bëhen më gjithëpërfshirëse dhe më lehtësisht të arritshme, të diskutojnë fushat ku bashkëpunimi dhe shkëmbimi i të dhënave me akterë tjerë me qëllim të përfitojnë të të dyja palëve (institucioneve), si dhe të japë rekomandime për të punuar me shoqërinë civile dhe partnerë të tjerë për ndarjen e informacionit publik zgjedhor për të rritur edhe më shumë transparencën e institucionit. Kjo do të nxisë qasje më të gjerë në të dhënat në dispozicion të publikut e që janë pjesë e sistemeve kompjuterike ekzistuese në dispozicion të KOZ-se. Po ashtu, do të krijohet një Open Data Grup Zgjedhor me aktorët kryesorë. Këto do të përfshijnë përfaqësues të institucioneve publike dhe institucionet administrative në nivel kombëtar dhe lokal, subjekteve politike, OJQ-ve, medias, sektori gjyqësor, organizatat ndërkombëtare, dhe votuesit. IFES do të këshillojë grupin mbi aktivitetet e mundshme, të cilat mund të përfshijnë ndarjen e përvojave ndërkombëtare të të dhënave të hapura, zhvillimin e parimeve të të dhënave të hapura zgjedhore për kontekstin e Kosovës, dhe mbështetja e KOZ-së në zbatimin e këtyre parimeve. IFES do të ofrojë asistencë teknike për zbatimin e këtyre parimeve. Kjo mbështetje do të vazhdojë gjatë vitit .	SKOZ/IFES	KOZ/KOZ														Krijimi i dokumentit-analizes me vlerësimin për hapjen e të dhënave	n/a	Financuar nga IFES

34	Hartimit të Planit të Integruar të Sigurisë	Hartimi i një Plani të Integruar të sigurisë me qëllim të vlerësimit të rrezikut në operacionet zgjedhore.	KT/DÇL	KOZ/KOZ														Plani i hartuar dhe aprovuar	Pa kosto	Buxheti i KQZ-së
----	---	--	--------	---------	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	------------------------------	----------	------------------

SHTYLLA STRATEGJIKE 6: Inovacioni dhe teknologjia

Synimet: Rritje e përdorimit të teknologjisë për operacione zgjedhore, Rritje e përdorimit të teknologjisë në shërbimet administrative, Ngritje e njohurive në aplikimin e teknologjisë në zgjedhje

35	Hartimi i Strategjisë së TI-së	Me përkrahje nga IFES, do zhvillohet një strategji e TI që synon zhvillimin e mëtutjeshëm të produkteve por edhe mirëmbajtjen dhe ofrimin e trajnimeve për të gjitha platformat kompjuterike aktuale. Strategjia do ka si cak sistematizimin e qasjes aktuale ad hoc për zhvillimin e sistemeve të IT në një të planifikuar, qasje të qëndrueshme, bazuar në Planin e saj Strategjik, dhe për të nxitur integrimin e sistemeve të TI të KQZ-së. Gjatë hartimit të strategjisë do të shqyrtohen edhe rekomandimet dhe parimet nga vlerësimi i të dhënave të hapura.	DTI/SKQZ/IFES	KOZ/KOZ														Strategjia e TI-së e hartuar	n/a	Financuar nga IFES
36	Zhvillimi i aplikacionit mobil për edukimin e votuesve	Do zhvillohen aplikacione (apps) për telefona celular dhe tablet, produkte këto për informim të votuesve e që në mënyrë specifike do të synohen grupacionet demografike të ndryshme, duke përfshirë të rinjtë. Këto aplikacione "Apps" do të japin informacion zgjedhor në mënyrë të thjeshtë dhe me shumë grafikë.	SKQZ/IFES	KOZ/KOZ														Aplikacioni mobil për edukimin e votuesve i zhvilluar	n/a	Financuar nga IFES
37	Integrimi i moduleve të Platformës për Operacion zgjedhore (ESMS dhe EOMP, etj.)	Aktualisht, integrimi i sistemeve kompjuterike të KQZ-së nuk është optimale. Ndërsa të dhënat në modulet e EOMP janë mirë të integruara, integrimi i ESMS me EOMP dhe lidhjet mes DMP dhe sistemit të ri GIS të adresave për listën e votuesve dhe me elemente të DMP do të rrisë funksionimin efektiv të këtyre sistemeve. Kudo që është e nevojshme të sigurohet ndërveprimi në mes këtyre sistemeve për punë më efektive do të bëhet integrimi i sistemeve.	DTI/IFES	KOZ/KOZ														Modulet e integruar ne një platforme të vetme	n/a	Financuar nga IFES
38	Sistemi për menaxhimin e informatave	Përmes zhvillimi të këtij sistemi, të gjitha të dhënat operacionale të zgjedhjeve janë të integruara në një sistem të vetëm informativ, që është i qasshëm nga të gjithë zyrtarët	DTI/SKQZ	KOZ/KOZ														Sistemi i zhvilluar, punonjësit e trajnuar	30,000.00	Buxheti i KQZ-së
39	Projekt për Zhvillimin e sistemit për menaxhimin e informatave të SP-ve	Aplikacioni lehtëson punën për menaxhimin e aktiviteteve të SP-ve, (Shtylla 6 e Planit Strategjik-inovacioni dhe teknologjia)	ZRPPC/IT	KQZ														Moduli online i zhvilluar	Me rishikim të buxhetit	Buxheti i KQZ-së
40	Hartimi i procedurave/udhëzuesve për • Aplikim online për certifikim • Aplikim online për vëzhgues • Ndjekjen e kurseve online • Ndërrimin e Qendrës së Votimit	Mbajtja e punëtorive për Hartimin e Procedurave/udhëzuesve do të ndihmoj të gjithë përdoruesit për të kuptuar me mirë rrjedhën e proceseve si dhe ndihmon në caktimin e përgjegjësive për administrimin e të dhënave përkatëse.	DTI/ZRPPC/DOZ/ KT	KOZ/KCL														Procedurat/udhëzuesit e hartuar	n/a	Financuar nga IFES
41	Organizimi i punëtorisë për trajnimin e përdoruesve të sistemeve	Përmes organizimit të një punëtorie tre ditore, do të bëhet trajnim me zyrtarët përgjegjës të njësive që përdorin sistemet duke përfshirë edhe ZLKZ-të. Kjo punëtori do të rrisë besimin se të gjithë zyrtarët kanë njohuri të mjaftueshme për përdorimin e sistemeve të implementuara.	DTI/ZRPPC/DOZ	KOZ/KOZ														Punëtorie e mbajtur dhe punonjësit e trajnuar	n/a	Financuar nga IFES

SHTYLLA STRATEGJIKE 7: Bashkëpunimi me akterët e jashtëm

Synimet: Partneritet dhe komunikim më i mirë me subjektet politike, shoqërinë civile dhe mediat, Promovim më i mirë i KQZ-së në nivel ndërkombëtarë

42	Informim për monitorimin e kuvendeve zgjedhore të partive politike	Zyra monitoron ecurinë e mbarëvajtjes së kuvendeve zgjedhore dhe përpilon raport	ZRPPC	KQZ														Raportet nga monitorimi i kuvendeve	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
43	Njoftimi i SP-ve për afatet e aplikimit të kërkesës për certifikim	Neni 15 i Ligjit për Zgjedhje	ZRPPC	KQZ														Subjektet e njoftuara	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
44	Raporti i shpenzimeve të fushatës	Deri 45 ditë pas DZ	ZRPPC	KQZ														Raportet e dorëzuara të shpenzimit të fushatës nga SP-te	pa kosto	Buxheti i KQZ-së

45	Publikimi i pasqyrave vjetore financiare të subjekteve politike audituara	Në bazë të Ligjit për Financimin e Subjekteve politike, KQZ-ja duhet t'i publikoj dhe t'i mbaj të publikuar të gjitha raportet vjetore financiare të subjekteve politike	ZRPPC/KQZ	KQZ												Pasqyrat financiare të publikuara	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
46	Takimet e rregullta me Subjektet politike	ZRPP mban takime të rregullta me përfaqësues të Subjekteve Politike me qëllim të njoftimit lidhur me obligimet e subjekteve.	KQZ/ZRPP	KQZ												Lista e pjesëmarrësve ne takime		Buxheti i KQZ-së
47	Monitorimi i Kuvendeve Zgjedhore	Zyra monitoron kuvendet zgjedhore të partive politike.	ZRPP/KQZ	KQZ												Lista e kuvendeve		Buxheti i KQZ-së
48	Hartimi i dosjes së informimit publik	Në bazë të LPZ, neni 43.2 ZRPP harton përbërjen e dosjes se informimit publik e cila publikohet në ueb faqen e KQZ-së.	ZRPP/KQZ	KQZ												Dosja e informimit [publik e hartuar dhe [publikuar	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
49	Shqyrtimi i Raportit Vjetor i NjAB-s për vitin 2016. Raporti Përmbyllës i KAB-it për vitin 2016.	Shqyrtimi i Raportit Vjetor për të vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit. Siguruar pavarësinë e Auditorit të Brendshëm.	KA	KA/KQZ												Hartimi i Raportit	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
50	Shqyrtimi i Raportit të NjAB-ës për Tremujorin e 1-rë të vitit 2017 (TM1/2017). Plotësimi dhe ndryshimi i Statutit të KAB-it.	Shqyrtimi i Raportit të NjAB për të vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit.	KA	KA/KQZ												Hartimi i Raportit	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
51	Shqyrtimi i Raportit të NjAB-ës për Tremujorin e 2-të të vitit 2017 (TM2/2017). Shqyrtimi i Raportit të auditimit të jashtëm të realizuar nga Zyra e Auditorit të Jashtëm.	Shqyrtimi i Raportit të auditimit të jashtëm të realizuar nga Zyra e Auditorit të Jashtëm për të siguruar që rekomandimet e auditimit janë pranuar dhe zbatuar.	KA	KA/KQZ												Hartimi i Raportit	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
52	Shqyrtimi i Raportit të NjAB-ës për Tremujorin e 3-të të vitit 2017(TM3/2017). Plani Strategjik për periudhën 2017 – 2019 dhe Plani Vjetor për Njësinë e Auditimit të Brendshëm për vitin 2017.	Shqyrtimi i Raportit dhe Planit Strategjik për të siguruar një mbikëqyrje të planeve dhe rezultateve të auditimit.	KA	KA/KQZ												Hartimi i Raportit	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
53	Evidenca e Progresit në zbatimin e rekomandimeve bazuar në Planin e Veprimit të Menaxhmentit dhe Orarit të përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve nga NjAB.Raporti Vjetor i KAB-it për vitin 2017.	Vështrimi i progresit në zbatimin e rekomandimeve bazuar në planin e veprimit. Këshillimi mbi çështjet lidhur me rreziqet, sistemet e kontrollit të brendshëm dhe auditimit.	KA	KA/KQZ												Hartimi i Raportit	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
54	Shënimi i ditës globale të zgjedhjeve	Shënimi i kësaj dite përmes organizimit të një ngjarje me përfaqësues të institucioneve, partive politike, OJQ-ve, etj. – ku do të prezantohen Historiku i Zgjedhjeve në Kosovë.	DOZ	KOZ/KQZ												Dita globale e shënuar/mbajtur	5.000.00 Euro	Buxheti i KQZ-së dhe OSBE
55	Takim Pune mes KQZ-se Subjekteve Politike dhe OJQ-ve vendore apo dhe ndërkombëtare	Përmes kësaj punëtorie synojmë të rritet bashkëpunimi i aktereve në zgjedhje, përmes të cilës synojmë që pasqyrimet nga akteret të jene korrekte nga secila pale.	KT/KçL	KOZ/KQZ												Takimi mbajtur	Pa kosto	Buxheti i KQZ-së
56	Vizitat zyrtare nga KQZ/SKQZ dhe Kryetareve nëpër të gjitha Komunat e RKS-se	planifikohet të bëhen vizita zyrtare nëpër komuna nga Anëtarët e KQZ-së dhe udhëheqësish së SKQZ-së, ku do të mbaheshin takime me Kryetar të Komunave, me qëllim ngritjes së bashkëpunimit për organizimin e zgjedhjeve;	KT/KçL	KOZ/KQZ												Se paku 35 vizita të realizuara	Pa kosto	Buxheti i KQZ-së
57	Azhurnimi vjetor i të dhënave të Subjekteve Politike	Partitë e regjistruar dorëzojnë të dhënat e ndryshuara vjetore sipas nenit 11 të rregullës Nr. 01/2013	ZRPPC	KQZ												Lista e të dhënave të SP-ve e azhurnuar	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
58	Raportet financiare vjetore të subjekteve politike	Sipas ligjit për Financimin e Subjekteve Politike neni 19 dhe rregullës 01/2013, Subjektet politike dorëzojnë raportet e shpenzimeve vjetore.	ZRPPC	KQZ												Raportet e dorëzuara (dokumentet)	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
59	Formulari për vazhdimin e regjistrimit të partive politike	Ne baze të LPZ neni 12.6 Partitë e regjistruara dorëzojnë formularin për vazhdim të regjistrimit.	ZRPPC	KQZ												Formularët e plotësuar të pranuar	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
60	Trajnimi i zyrtareve financiar të SP-ve,	Sipas nenit 40.7 të LPZ Zyra organizon trajnimin për zyrtaret financiar të SP-ve Plotësimi i formave të shkurtuara	ZRPPC	KQZ												Zyrtaret financiar të trajnuar	n/a	KQZ/ IFES
61	Regjistrimi i partive politike	Duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, neni 3 të Rregullës nr.01/2013	ZRPPC	ZRPP/KQZ												Kërkesat për regjistrim të proceduara	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
62	Raportimi i Pasqyrave financiare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2016	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përgatit, shqyrton dhe aprovon Raportin vjetor financiar për vitin 2016. Këtë raport e dorëzon në MF më së voni me 31 janar 2017.	Divizioni i Financave	KBF/KQZ												Raporti i aprovuar dhe dërguar	pa kosto	Buxheti i KQZ-së

63	Raportimi detal dhe analitik i shpenzimeve ne çdo tre (3) muaj në KBF dhe miratimi nga KQZ;	Raportimi i shpenzimeve të buxhetit pas çdo periudhe tremujore	Divizioni i Financave	KBF/KQZ													Raportimi i aprovuar ne Këshilla dhe KQZ	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
64	Raporti i shpenzimeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të komunës së Glllogocit	Raporti për shpenzimet për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Glllogoc	Divizioni i Financave	KBF/KQZ													Raporti i miratuar dhe dërguar	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
65	Raporti vjetor për Kuvendin e Kosovës për shpërndarjen dhe shpenzimin e mjeteve nga fondi për financimin e subjekteve politike	Bazuar ne Ligjin 03/L174 neni 15, KQZ-ja duhet ti publikoj të gjitha raportet vjetore financiare së bashku me deklaratën e auditimit të subjekteve politike në faqen zyrtare të saj	Divizioni i Financave	KBF/KQZ													Raporti i miratuar dërguar	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
66	Raporti financiar (9 -mujor)	Jo më vonë se me 31 Tetor të çdo viti kalendarik, Organizatat buxhetore do të përgatitë dhe dorëzojë MF ,një raport përfundimtar përmbledhës të buxhetit për 9 mujorin vitit aktual fiskal dhe 9 mujorët e dy vitet paraprake fiskale, i cili përfshin: të dhënat sipas nenit 46 të ligjit për Menaxhimin e Financave publike dhe Përgjegjësit.	DAP	KBF/KQZ													Raporti i hartuar dhe miratuar nga KQZ	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
67	Transferimi i mjeteve për Subjektet Politike për TM1, TM2, TM3, TM4- 2017	Transferimi i mjeteve të subjekteve politike ne periudha tremujore	DAP	KBF/KQZ													Mjetet e transferuara	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
68	Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë së Komunikimit me Aktert e Jashtëm	KQZ-në do zhvilloj një strategjie të komunikimit me akteret e jashtëm së bashku me një plan veprimi vjetor. Strategjia do synoj sistematizimin e qasjes aktuale ad hoc për informim të publikut dhe akterve të jashtëm, prapasja e një qasje të integruar dhe të planifikuar, qasje të qëndrueshme, e cila bazohet edhe në Planin Strategjik. IFES do të ekspertizën e nevojshme që së bashku me stafin e KQZ të hartohet një strategji gjithëpërfshirëse dhe e zbatueshme në kushtet ekzistuese.	SKQZ/IFES	KOZ/KQZ													Dokumenti i strategjisë aprovuar (dhe publikuar)	n/a	Buxheti i IFES
69	Trajnim për partitë politike		ZRPPC	KQZ														n/a	Buxheti i KQZ-së

SHTYLLA STRATEGJIKE 8: Korniza Ligjore

Synimi: Kornizë e plotë dhe efektive nënligjore

70	Plotësim/ndryshimi i Udhëzuesit për Menaxher të QV-ve dhe Staf teknik	Udhëzuesi si i tille qe është, duhet patjetër të ndryshohet dhe të harmonizohet sipas LZP-se, Rregullave zgjedhore dhe Doracakut të Trajnimit	KT/DOZ/DÇL	KOZ/KQZ													Udhëzuesi i plotësuar	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
71	Rishikimi i Udhëzimit Administrativ 01/2012 për Zëvendësimin e anëtareve të kuvendeve komunale	Harmonizimi Udhëzimit Administrativ me Rregulloren e Punës të KQZ-së.	DÇL/KT	KBF/KQZ													Udhëzimi Administrativ i ndryshuar me plotësimet dhe ndryshimet	pa kosto	Buxheti i KQZ-së
72	Ndryshim/plotësim memorandumi mes KQZ-se-PK-se-Prokurorisë- PZAP-dhe KGJK-se	Memorandumi aktual, duhet patjetër të ndryshohet ku secili institucion duhet t'i ketë detyrat dhe përgjegjësitë sipas akteve ligjore ne fuqi, apo dhe detyrimet qe kane palët ndaj palës tjetër	KT/KÇL	KOZ/KQZ													Memorandumi i plotësuar	pa kosto	Buxheti i KQZ-së

Aktivitetet tjera të mbështetura nga OSBE

73	Publikimi i historikut të zgjedhjeve në Kosovë	Misioni ne bashkëpunim me KQZ do të financoje promovimin e historikut të zgjedhjeve ne Kosove (printimi dhe financimi i ngjarjes do të mbështetet nga OSBE-ja) do të behet ne shkurt të vitit 2017 dhe do t'i mbledh se bashku përfaqësuesit e subjekteve politike, të OJQ-ve, etj. (përafërsisht 100 pjesëmarrës)	OSBE/SKQZ	KOZ/KQZ													Dokumenti i miratuar dhe publikuar	n/a	OSBE
74	Konferencë rajonale me TMZ-të	Misioni ne bashkëpunim me Misionet e OSBE-te ne rajon dhe me KQZ-te do të organizoje një konferencë të përbashkët 2 ditore me qellim të shkëmbimit të përvojave ne teknologjinë zgjedhore, si p.sh.. Identifikimi elektronik i votuesve, numërimi elektronik, identifikimi biometrik, transmetimi i drejtpërdrejtë i rezultateve etc. OSBE do të mbuloje shpenzimet për pjesëmarrësit (nga 5 pjesëmarrës nga KQZ të Kosovës, Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë)	OSBE/SKQZ	KMJ/KQZ													Pjesëmarrja dhe prezantimi ne Konferencë	n/a	OSBE

75	Punëtorja për trupat gjyqësor rreth bashkëpunimit në zgjedhje	Ngjashëm me aktivitetin e vitit 2016 Seksioni do të organizoj një punëtorë për përfaqësuesit e TMZ, Policisë së Kosovës , Prokurorisë dhe Këshillit Gjyqësor që të diskutohet rreth bashkëpunimit të tyre gjatë procesit zgjedhor dhe si të preventohen shkeljet ligjore. Punëtorja do të diskutojë edhe modalitetet e implementimit të MM të nënshkruar me 2 Shkurt 2016. Punëtorja do të mbahet në katër muajt e parë të 2017 dhe do të përfshijë 25 pjesëmarrës (9 OSCE) 4 nga KQZ, 3 PZPA, 3 PK, 3 Prokuroria dhe 3 KGJK.	OSBE/SKQZ	KMJ/KQZ												Mbajtja e punëtorisë dhe ofrimi i rekomandimeve	n/a	OSBE
76	Mbështetja për Grupin Punues të Listës së Votuesve	Misioni do të mbështes grupin punues për LV që përbehet nga KQZ dhe MPB/QRC në identifikimin e mënyrës së përmirësimit të kualitetit të LV Brenda kornizës ligjore. Ky aktivitet parashihet me rezultatin e aktiviteteve 2016/2017 që kanë të bëjnë me rishikimin e legjislacionit sekondar që ka për qëllim krijimin e një LV sa më të mirë. Parashihen që të bahen 2 punëtorë secila nga 1 ditë me nga 30 pjesëmarrës (7 nga OSCE duke përfshirë përkthyesit) 12 nga KQZ/S dhe 11 nga MPB/QRC. Punëtorja e parë të mbahet në Mars 2017 kurse e dyta –varet prej kërkesës-mes Marsit dhe Majit 2017.	OSBE/SKQZ	GPLV/KQZ												Pjesëmarrja në takime dhe ofrimi i rekomandimeve	n/a	OSBE
77	Punëtorë të përbashkëta me TMZ-të dhe OJQ-te në terren	Misioni në bashkëpunim me KQZ dhe PZAP dhe duke u bazuar në planin e tyre strategjik do të organizoj 6 punëtorë në terren që të krijoj një forum për pjesëmarrësit (TMZ dhe OJQ) të shkëmbejnë informacione rreth procesit zgjedhor, të vetëdija OJQ-te rreth hapave kryesor të procesit zgjedhor , të drejtat dhe obligimet e tyre (p.sh. nëse OJQ dëshirojnë të vëzhgojnë zgjedhjet), të diskutojnë rreth çështjeve gjinore etj. Prej 2014/2015 OJQ kanë shpreh dëshirën të kane MM të KQZ dhe në këtë forum mund të diskutohen edhe detajet. Punëtoritë do të mbahen në Mars Prill 2017 secila punëtorë njëditore për 25 pjesëmarrës në secilën prej tyre (7 nga OSCE) 7 prej KQZ/S dhe PZAP dhe 11 prej OJQ.	OSBE/SKQZ	KMJ/KQZ												Punëtorja e mbajtur	n/a	OSBE
78	Punëtorja rreth Planifikimit të zgjedhjeve 2017	Në mënyrë që të asistoj TMZ në hartimin e planeve operacionale 2017 dhe të diskutoj edhe për detajet e asistencës që Misioni mund të ofroj Misioni do të organizoj 1 punëtorë për KQZ-në 2 ditore për KQZ. Punëtorja për KQZ do të mbahet në Prill-Maj varësisht prej shpalljes së zgjedhjeve dhe do të përfshijë 33 pjesëmarrës (9 nga OSCE) 11 nga KQZ dhe 13 nga SKQZ	OSBE/SKQZ	KMJ/KQZ												Mbajtja e punëtorisë	n/a	OSBE
79	Punëtorja me KQZ mësimet e nxëna dhe vlerësimi i aktiviteteve	Punëtorja 2 ditore do të organizohet nga Misioni dhe do të diskutohen të gjeturat dhe rekomandimet nga monitorimi i aktiviteteve të KQZ në 2017. Punëtorja do të shërbejë si mundësi për KQZ/S të hartoj mësimet e tyre të nxënë prej zgjedhjeve 2017, të rishikoj dhe vlerësoj aktivitetet në 2017 dhe të planifikojnë për 2018. Rekomandimet nga Misioni do të konsiderohen si mundësi për të rritur funksionimin e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e aktiviteteve zgjedhore në të ardhmen. Si rezultat i Punëtorisë Misioni do të përgatit një prezantim me të gjeturat dhe rekomandime që do të jete në konsideratë të KQZ-se. Pjesëmarrësit do të jete 11 anëtarë KQZ, 5 staf të Menaxhmentit të Sekretariatit dhe 4 staf të OSCE.	OSBE/SKQZ	KMJ/KQZ												Mbajtja e punëtorisë dhe ofrimi i rekomandimeve	n/a	OSBE